

GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 33183/07

**PRIMA SHPK DHE ARTAN KOZMAI
KUNDËR SHQIPËRISË**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 19 shtator 2023, si Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *President,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit,*

duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 33183/07) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa"), më 25 korrik 2017, nga Prima sh.p.k., shoqëri tregtare e themeluar në Shqipëri, dhe një shtetas shqiptar z. Artan Kozmai, i lindur në vitin 1962 dhe banues në Tiranë. Kërkuesi i dytë është pronari dhe administratori i kërkuesit të parë, shoqërisë tregtare. Kërkuesit përfaqësohen në Gjykatë nga z. A.Hajdari dhe z. A. Brovina, avokatë të licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar Qeverinë Shqiptare ("Qeveria") të përfaqësuar nga Agjenti i saj në atë kohë, z. N.Naço, ish-ministër i Drejtësisë dhe më pas nga z. O.Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, për ankimimet në lidhje me mosshqyrtimin nga Gjykata e Lartë të pretendimit të kërkuesve se padia e paditësve ishte jashtë afatit, sipas nenit 6 § 1 të Konventës dhe të drejtën e pronësisë së kërkuesve, sipas nenit 1, të Protokollit nr. 1, të Konventës dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

38. Çështja ka të bëjë me shkeljen e dyshuar të të drejtave të kërkuesve për gjykim të drejtë dhe respektimin e pronës si pasojë e vendimit të Gjykatës së Lartë në një çështje civile.

39. Më 16 gusht 1997, Këshilli Bashkiak për Planifikimin Territorial të Tiranës (këtu e më poshtë "Këshilli") i dha shoqërisë kërkuese një leje planifikimi për një parcelë toke në pronësi të kërkuesit të dytë dhe e miratoi atë më 14 tetor 1997.

40. Në një datë të pa saktësuar në vitin 1998, pas fillimit të punimeve nga shoqëria kërkuese, fqinjët në ndërtesën ngjitur depozituan një padi civile kundër shoqërisë kërkuese, ku kërkonin pezullimin e ndërtimit dhe shfuqizimin e vendimeve të Këshillit.

41. Më 5 maj 1998, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ("Gjykata e Rrethit") urdhëroi pezullimin e punimeve të ndërtimit.

42. Më 20 nëntor 1998, Gjykata e Rrethit Gjyqësor pranoi pjesërisht padinë civile, por nuk u mor vendim në lidhje me kërkesën për shfuqizimin e vendimit të Këshillit. Më 16 prill 1999, Gjykata e Apelit Tiranë ("Gjykata e Apelit") la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

43. Më 8 mars 2000, Gjykata e Lartë prishi vendimet e të dyjave gjykatave më të ulëta dhe ktheu çështjen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor për t'u shqyrtuar përsëri nga një trupë tjetër gjyqësore.

44. Më 16 prill 2002, Gjykata e Rrethit Gjyqësor pranoi pjesërisht padinë civile, duke urdhëruar shoqërinë kërkuuese që të mos ndërhyjë në të drejtat e pronës së paditësit. Ajo gjithashtu rrëzoi si të pabazuar pjesën e padisë në lidhje me shfuqizimin e lejes së ndërtimit.

45. Shoqëria kërkuuese e ankimoi dhe, më 21 korrik 2003, Gjykata e Apelit përmbysi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe rrëzoi padinë e paditësit, duke u shprehur që pretendimi kryesor, që kishte të bënte me kërkesën për shfuqizimin e lejes së ndërtimit, ishte depozituar jashtë afatit kohor prej tridhjetë ditësh, të përcaktuar në nenin 328 të Kodit të Procedurës Civile.

46. Më 23 nëntor 2004, Gjykata e Lartë prishi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe konstatoi se ndërtimi i ri përbënte rrezik për pronën e paditësit dhe urdhëroi shoqërinë kërkuuese që të mos ndërhynte më tej.

47. Gjithashtu, Gjykata e Lartë shfuqizoi lejet e planifikimit dhe ndërtimit, duke u shprehur që ishin në shkelje të Ligjit për Urbanizimin 1993. Më tej u shpreh se meqë leja e ndërtimit ishte nxjerrë për një periudhë gjashtëmujore dhe nuk ishte depozituar kërkesë për rinovimin e saj, vendimet që miratonin këto leje duhej të shfuqizoheshin.

48. Më 30 janar 2007, Gjykata Kushtetuese me panel të përbërë nga tre gjyqtarë, shpalli të papranueshëm ankimin kushtetues të shoqërisë kërkuuese.

VLERËSIMI I GJYKATËS

49. Kërkesit argumentuan që mostrajtimi nga Gjykata e Lartë i kundërshtimit të tyre, në lidhje me pranueshmërinë e pretendimit të paditësit, përbënte shkelje të detyrimit të gjykatave për të arsyetuar vendimet e tyre dhe ndërhyrje në të drejtat e tyre për pronën, sepse nëse Gjykata e Lartë do të kishte konstatuar që padia civile e paditësve ishte depozituar jashtë afatit, leja e ndërtimit të kërkesit nuk do të ishte shfuqizuar. Kërkesit u bazuan në nenin 6, paragrafi 1, të Konventës dhe në nenin 1, të Protokollit nr. 1.

50. Gjykata nuk e ka për detyrë të trajtojë çështjen e statusit viktimë të kërkesit të dytë sepse, edhe nëse supozojmë se ai ka legjitimitet, kërkesa në çdo rast është e papranueshme për shkaqet e mëposhtme.

A. Neni 6, paragrafi 1, i Konventës

51. Gjykata përsërit që sipas praktikës së saj të konsoliduar që pasqyron një parim në lidhje me administrimin e duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet të shprehin mjaftueshëm arsyet mbi të cilat ato bazohen (shihni *çështja García Ruiz kundër Spanjës* [GC], nr. 30544/96, § 26, GJEDNJ 1999-I). Sipas këtij detyrimi një palë në proces gjyqësor mund të presë një përgjigje specifike dhe të shpejtë për ato parashtrime që janë vendimtare për rezultatin e procesit në fjalë (shihni *çështja Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë* [GC], nr. 55391/13 dhe 2 të tjerë, § 185, 6 nëntor 2018).

52. Masa në të cilën zbatohet ky detyrim për arsyetim mund të jetë e ndryshme sipas natyrës së vendimit dhe mund të vendoset vetëm nisur nga rrethanat e çështjes: është e nevojshme të mbahet parasysh *inter alia* larmia e parashtrimeve që një palë ndërgjyqësore mund të sjellë përpara gjykatave dhe dallimet që ekzistojnë në shtetet Palë Kontraktuese, në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, opinionet ligjore dhe prezantimin, dhe hartimin e vendimeve (*çështja Ruiz Torija kundër Spanjës*, 9 dhjetor 1994, § 29, seria A nr. 303-A, dhe *çështja Hiro Balani kundër Spanjës*, 9 dhjetor 1994, § 27, seria A nr. 303-B).

53. Fillimisht i takon autoriteteve kombëtare, sidomos gjykatave, që të zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit të brendshëm. Kjo vlen në veçanti për interpretimin që gjykatat i bëjnë rregullave me natyrë procedurale siç është mënyra e parashikuar dhe afati i parashikuar për depozitimin, *inter alia* e një padie civile ose ankimimi. Roli i Gjykatës është i kufizuar me konstatimin nëse efektet e këtij interpretimi janë në përputhje me Konventën (shihni *çështja Platakou kundër Greqisë*, nr. 38460/97, § 37, GJEDNJ 2001-I).

54. Në lidhje me çështjen në fjalë, Gjykata vëren që padia civile kishte të bënte me dy pretendime kryesore: që punimet e shoqërisë kërkuese të pezulloheshin dhe që vendimet e Këshillit që autorizonin ndërtimin të prisheshin. Secili pretendim ishte objekt i një afati të ndryshëm parashkrimi. Për pretendimin e parë ishte një vit nga fillimi i punimeve të ndërtimit dhe për pretendimin e dytë ishte tridhjetë ditë nga data e dhënies së lejes së ndërtimit ose nga data e marrjes dijeni nga palët e interesuara. Nuk kontestohet që pretendimi i parë është depozituar brenda afatit të parashkrimit. Megjithatë, pretendimi i dytë është depozituar më shumë se tridhjetë ditë pas miratimit të lejes së ndërtimit. Meqë ky vendim nuk ju njoftua fqinjëve, nuk është e mundur që të përcaktohet data e saktë e marrjes dijeni prej tyre.

55. Gjykata konstaton që edhe nëse vendimi i Gjykatës së Lartë nuk trajtoi shprehimisht pyetjen nëse pretendimi në lidhje me shfuqizimin e lejes së ndërtimit ishte i parashkruar, duhet vërejtur që, siç arsyetoi Gjykata e Lartë, ishte e qartë nga dosja se leja e ndërtimit ishte dhënë vetëm për gjashtë muaj, dhe shoqëria kërkuese nuk kishte dorëzuar kërkesë për rinovimin ose zgjatjen e saj. Për këtë shkak, leja e ndërtimit nuk ishte e vlefshme, pavarësisht çdo vendimi gjyqësor. Prandaj, fakti që Gjykata e Lartë nuk e trajtoi pyetjen nëse ajo pjesë e pretendimit të paditësve ishte e parashkruar nuk mund të kishte ndikuar në vlefshmërinë e lejes së ndërtimit, sepse afati i saj tashmë kishte përfunduar.

56. Problemet kryesore për vendimmarrje nga gjykatat e brendshme ishin nëse ndërtimi nga shoqëria kërkuese ndikonte negativisht në ndërtesat e fqinjëve dhe nëse ndërtimi ishte në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues. Këto pyetje u trajtuan me kujdes nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj, duke renditur mospërputhjet e lejes së ndërtimit me Planin e Urbanizimit 1993 dhe duke konstatuar që të drejtat e pronës së fqinjëve të shoqërisë kërkuese do të ishin shkelur nëse ndërtimi do të kishte përfunduar.

57. Në këto rrethana, Gjykata konsideron që ankimi i kërkuesve për mungesën e arsytimit të vendimit të Gjykatës së Lartë është haptazi i pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

B. Neni 1, i Protokollit nr. 1

58. Gjithashtu, kërkuesit paraqitën ankim sipas nenit 1, të Protokollit nr. 1, me pretendimin e shkeljes së të drejtës së tyre për gëzimin e qetë të pronës së tyre, për shkak të shfuqizimit të lejes së ndërtimit. Nisur nga vlerësimi i mësipërm, sipas nenit 6 § 1 të Konventës, Gjykata konsideron se, bazuar në tërësinë e materialit në dispozicion të saj dhe në masën që kjo çështje është brenda kompetencës së saj, ky ankim nuk tregon ndonjë shfaqje të shkeljes së të drejtave dhe lirive të shprehura në Konventë ose në Protokollin e saj. Duke pasur parasysh arsyet e dhëna nga gjykatat e brendshme (d.m.th mbarimin e afatit të lejes së ndërtimit, në zbatim të neneve 60 dhe 33 të Ligjit për Urbanizimin, mungesa e vigjilencës nga kërkuesit që nuk kërkuan rinovimin e saj dhe mosrespektimi i legjislacionit për urbanizimin), Gjykata konsideron se vendimi i gjykatave që rezultoi në shfuqizimin e lejes së ndërtimit nuk gjeti shkelje të të drejtave të pronës së kërkuesve (shihni *mutatis mutandis*, çështja *Gorraiz Lizarraga dhe të Tjerët kundër Spanjës*, nr. 62543/00, § 70, GJEDNJ 2004-III)

59. Për rrjedhojë, ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 12 tetor 2023.

Olga Chernishova
ZËVENDËSKANCELARE
Georgios A. Serghides

PRESIDENT